



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 1162 prot.

Tiranë, më 30 . 04 .2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 3255/1, DATË 27.12.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASI Z. HETEM SHEHAJ”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e bashkuara të paraqitura nga z. Hetem Shehaj me nr. 2124 prot., datë 21.04.2021, nr. 2124/2 prot., datë 11.05.2021, nr. 2124/3 prot., datë 07.07.2021 dhe nr. 2124/4 prot., datë 20.09.2021, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit J.Ç. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrër, në kohën e kryerjes së shkëljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 3255/1 prot., datë 27.12.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. Hetem Shehaj”, bazuar në nenin 122, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Rruga “Ilia Dilo Sheperi”, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

